

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. IRMA BALLI

02/19/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 12.02.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Irma Balli, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 19.02.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Irma Balli, prokurore pranë Prokurorisë së Apelit Korçë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Lulzim Hamitaj, z. Olsi Komici relator, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve .

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.